



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-41160 /2025

Klinë, datë 11 / 12 /2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit, nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës, nr.01-110-1232/2010 të dt.07.04.2010, e ne mbështetje të dispozitave të neneve 7 dhe 10 të Rregullores Komunale, nr.01-463-34997/2021 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më Pak së Një Vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kryetari i Komunës nxjerr, **këtë:**

V E N D I M

Për formimin e komisionit për dhënien në shfrytëzim
më pak së 1 vit të hapësirave publike

1. **FORMOHET**, komisioni komunal për shqyrtimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për shfrytëzimin e përkohshëm më pak së një (1) vit të hapësirave publike. Përbërja e komisionit është, siç vijon:
 - 1.1. Visar Bojaj, kryesues;
 - 1.2. Adnan Zeneli, anëtar;
 - 1.3. Xhezide Trapça- Gashi, anëtar;
2. Komisioni benë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim më pak së një vit, si dhe i rekomandon kryetarit të komunës për nënshkrimin e kontratës.
3. Komisioni punën e vet e kryen në përputhje me dispozitat e Rregullores për Përcaktimin e procedurave të dhënies më pak së një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, nr.01-463-34997/2021, si dhe dispozitat tjera ligjore dhe nënligjore pozitive të cilat rregullojnë këtë fushe.
4. Mandati i komisionit është dy (2) vite nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
5. Ky vendim është i plotfuqishëm nga data e nënshkrimit të tij nga Kryetari i Komunës.

Te njoftohen:

- Të përmendurit;
- Drejtoria e UMM;
- Zyra e Informimit, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

